

# ALBANESE

## ALARM? SHIKO ME KUJDES NGYRAT!

Pas miratimit të Dekretit Rajonal n.1057 të datës 5 tetor 2015, Rajoni Liguria ka vendosur **klasifikimin e Alarmit** në bazë të kodeve me ngjyra: e verdhë - portokalli - e kuqe, në vend të klasifikimit të mëparshëm, alarm 1 dhe alarm 2 (allerta 1 e allerta 2).

**Alarmet janë parashikime për ngjarjet e motit të vlefshme vetëm për rreziqet hidrogeologjike (përmbytjet) dhe nivologjiko (reshjet e dëborës).**

Faza e parashikmit dhe përhapjes së alarmeve nga ana e Arpal/Rajoni Liguria, do të tregohet herë pas here, me një nga tre alarmet e renditura më poshtë, në përputhje me nivelin në rritje të rrezikut:

GIALLA	ARANCIONE	ROSSA
<b>E VERDHË</b> Fenomene të rëndësishme  <u>Kujdes, informohu</u>	<b>PORTOKALLI</b> Fenomene intensive  <u>Kujo rregullat e vetëmbrojtjes dhe rri në gadishmëri</u>	<b>E KUQE</b> Fenomene shumë intensive  <u>Zbato të gjitha rregullat e sjelljes të parashikuara për situatat e rrezikshme</u>

## Të informohemi

Para, gjatë dhe pas ngjarjes ndiq të rejat dhe kërko të gjitha lajmërimet e nevojshme nëpërmjet kanaleve të komunikimit që vihen në dispozicion prej institacioneve dhe mediave.

### Kanalet institucionale:

- Faqet e internetit
  - [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it)
  - [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it)
  - [www.meteoliguria.it](http://www.meteoliguria.it)
- Facebook e twitter i Mbrojtjes Civile të komunës
- Facebook e twitter i Komunës Genova
- Shërbimi SMS: regjistrohu falas duke dërguar mesazhin “allertameteo on” në numrin 339 9941051
- Tabelat rrugore elektronike
- Tabela informuese në stacionet e autobusëve
- Numri jeshil i mbrojtjes civile për urgjenzat 800177797
- Numri i qendrës operative të Policisë Bashkiake 0105570

### Kanale të tjera:

Mediat lokale (tv, radio, gazeta on line dhe rrjetet sociale përkatëse).


# PËRMBYTJET

## HYRJE

Rreziku hidrogeologjik parashikon statusin e Alarmit nga Arpal dhe Rajoni Liguria, kur ka parashikim të ndonjë rreziku meteorologjik.

Alarmi njoftohet përmes sitit të Arpal [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it) si edhe nga faqja kyesore e Komunës [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it).

Zonat alarmuese në Liguria:



Genova është komunë që futet në zonën e rrezikshmërisë "B", brigje Detare Qëndrore. Zonat e interesuara nga alarmi tregohen herë pas here në deklaratat e gjendjes së Alarmit në sitin [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it).



Me anë të Decretit Rajonal n. 1057, 5 tetor 2015, hyri në fuqi një sistem i ri paralajmërimi me tre nivele të bazuara në kodet me ngjyrë të verdhë, portokalli, të kuqe.

Të dish nëse jeton ose punon në një zonë që paraqet rrezik nga përmbytjet, do të të ndihmojë për të parandaluar dhe përballuar më mirë këto lloje rreziqesh: për këtë mund të kontrollosh Hartografitë, Planin Komunal të Urgjencës – Skemën Operative për Rrezik Moti e Hidrologjik dhe Urdhëresat ose Rregulloret për Rrezik Përmbytjesh (gjenden në pikën "Normativa" dhe në sitin e Mbrojtjes Civile [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it)).

Alarmet vendosen në bazë të parashikimit të motit dhe duhet të përballohen duke zbattuar rregullat e sjelljes të paracaktuara. Mbrojtja Civile e Komunës, megjithatë, mund t'u japë qytetarëve informacione të tjera të rëndësishme që duhet të pasur parasysh sa herë që lajmërohen qytetarët për ndonjë problem të veçantë ose rrezik, kjo, për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.

Këto të dhëna shpërndahen përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit institucional dhe të mediave.

## NUMRA TË DOBISHËM

800 177797 - numri i Mbrojtjes Civile  
010 5570 - Policia Bashkiake

## RREGULLAT E SJELLJES

### Para fillimit të Alarmit

- Kushto vëmendje të rejave mbi motin në sitet [www.meteoliguria.it](http://www.meteoliguria.it) dhe në [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it), të cilat gjenden edhe në faqen e internetit të Komunës.
- Përbaju udhëzimeve të dhëna nga autoritetet. Gjithashtu mund të gjesh informacione duke kontrolluar tabelat rrugore, tabelat në stacionet e autobusëve, faqet Facebook - Twitter të Komunës ose të Mbrojtjes Civile dhe të duke ndjekur tv dhe radio.

Disa pjesë të qyteteve përmbyten para të tjarave: nënkalimet, rrugët afër lumejve, urat dhe në përgjithësi të gjitha zonat e ulëta të qytetit. Edhe katet më të ulëta të ndërtesave janë më të rrezikuara nga përmbytjet: kantina, bodrume dhe dhoma në ose nën nivelin e rrugës.

#### **Disa veprime të thjeshta mund të të ndihmojnë për sigurinë e vetes dhe njerëzve që jetojnë afër teje:**

- nëse jeton apo punon në zonat e rrezikshme nga përmbytjet, mos qëndro ose mos kalo natën në lokale apo në bodrume të vendosura në nivel me rrugën
- vendos panele mbrojtëse ose thasë rëre pjesë e shtëpisë në nivel me rrugën mbylli dyert e kantinave, garazhevë dhe bodrumeve
- largo makinën ose motorrin në një zonë më lart pa rrezik përmbytjesh
- kufizo lëvizjet
- mbaj në shtëpi kuti të ndihmës së shpejtë, radio me bateri, elektrik dore, fikës zjarri
- abonohu në shërbimin falas të lajmwrimeve urgjente duke dërguar mesazhin “**allertameteo on**” në 339 9941051.

#### **Gjatë alarmit dhe kur përmbytjet po ndodhin**

- Ndiq ngryshimet e motit në internet si dhe nga faqja kryesore e Komunës: [www.meteoliguria.it](http://www.meteoliguria.it) / [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it)
- Mos hy ose qëndro në garazhe, bodrume ose dhoma në nivel me rrugën deri në fund të ngjarjes dhe ngjituni në katet e larta
- Mbro me panele ose thasë rëre pjesë e shtëpisë në nivel me rrugën, mbyll dyert e kantinave, garazheve dhe bodrumeve por pa rrezikuar
- Mos kalo e mos ndalo në ura, nënkalime, brigje të lumejve
- Mos u mundo të arrish në destinacion, por kërko strehim në një vend të sigurt e të afërt
- Dil vetëm në raste të nevojshme dhe përdor mjetet e transportit publik, do të udhëtosh më i sigurt dhe nuk do të bllokosh trafikun e automjeteve të urgjencës
- Informohu mbi ndryshimet në lëvizjen e transportit publik në faqen: [www.amt.genova.it](http://www.amt.genova.it);
- Shkëput pajisjet elektrike dhe të gazit edhe pse mund të jenë të vendosura në vende të sigurta të shtëpisë
- Kufizo përdorimin e telefonit/celular: duke mbajtur linjat e lira ndihmojmë punën e ndihmës së shpejtë
- Mos braktis një vend të sigurt para se të jetë shpallur fundi i Alarmit
- Informohu mbi detajet dhe rekandimit e ofruara nga Autoritetet nëpërmjet [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it), në faqen Facebook - Twitter të Mbrojtjes Civile dhe Facebook - Twitter të Komunës, tv, radio, tabelat e rrugës dhe të stacineve të autobusëve.

#### **Pas alarmit dhe ndalimit të përmbytjeve**

- Para se të largohesh nga një vend i sigurt, sigurohu që është shpallur ndërprerja e Alarmit
- Para se të pish ujë nga rrubineti sigurohu që nuk është e ndaluar nga Ndonjë Urdhëresë Komunale
- Mos kalo përgjatë rrugëve të përmbytura: uji mund të fshehë gropë, vrima, puseta të hapura
- Kontrollo nëse mund të riaktivizosh gazin dhe sistemin elektrik dhe nëse është e nevojshme kërko një teknik
- Para se të përdorësh sistemin e shkarkimit, sigurohu që kanalizimet, kanalet biologjike, puset nuk janë dëmtuar.

# DËBORË

## HYRJE

Rreziku në lidhje me rreshjet e dëborës, parashikon vënien e gjendjes së Alarmit nga Arpal i Qarkut Liguria, si pasojë e parashikimit të një gjendje kritike metereologjike. Alarmet janë të publikuara në faqen zyrtare të Arpal [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it).

**Me Rezolutën Rajonale n. 1057 të datës 5 tetor 2015, u vendos një sistem i ri paralajmërimi me tre nivele alarmi, bazuar në kodet me ngjyrë të verdhë, portokalli, të kuqe.** Alarmet përhapen mbi bazën e parashikimeve të motit dhe duhet të

trajtohen duke zbatuar rregullat e sjelljes së janë të parashikuara.

Mbrojtja Civile e Komunës, megjithatë, mund t'u sigurojë qytetarëve informacione të dobishme sa herë që konsiderohet e përshtatshme për të informuar qytetarët për ndonjë problem kritik, me qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.

Këto informacione shpërndahen përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit institucional dhe mediave.

## NUMRA TË DOBISHËM NË RAST URGJENCE NGA DËBORA

800 177797 - numri i Mbrojtjes Civile  
010 5570 - Policia Bashkiake

## RREGULLAT E SJELLJES

### Përpara

Kushtoji vëmendje të rejave mbi motin në sitin [www.meteoliguria.it](http://www.meteoliguria.it) dhe ndiq udhëzimet e dhëna nga Autoriteti. Mund të gjesht informacione të dobishme mbi alarme në [www.allertaliguria.gov.it](http://www.allertaliguria.gov.it), në faqen e internetit të Komunës [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it), në tabelat elektronike rrugore, tabelat në stacionet e autobuzëve, në faqet Facebook dhe Twitter të Mbrojtjes Civile dhe në faqet Facebook dhe Twitter të Komunës ose të televizioneve dhe radiove lokale.

Përveç kësaj

- vendos gomat e dëborës ose mbaj zinxhirët në automjetin tênd
- përgadit mjetet e duhura kundër dëborës ose akullit: lopatë dhe kripë janë të domosdoshme për lirimin e hyrjes në banesën ose në ndërmarrjen tênde
- pë qotë se duhet të dalësh, lër në shtëpi makinën dhe përdor mjetet e transportit publik.

### Gjatë Alarmit dhe gjatë kohës së rënies së dëborës

- Përdor mjetet e transportit publik, do të udhëtosh i sigurt dhe pa bllokuar automjetet e urgjencës
- Informohu për ndryshimet e qarkullimit të transportit publik në faqen e internetit [www.amt.genova.it](http://www.amt.genova.it)
- Mos përdor mjete transporti me dy rrota, në raste të reshjeve të dëborës, një Urdhëresë e Kryetarit të Komunës mund ta ndalojë udhëtimin e tyre

- Nëse je idetyuar të përdorësh makinën, monto gomat e dëborës ose zinxhirët; nëse nuk arrin të vazhdosh udhëtimin, parko anash rrugës
- Hiq dëborën dhe akullin përpara derës tënde, kalimit privat, lokalit ose dyqanit tuaj, por mos i hidh në rrugë, mund bëhen pengesë për të tjerët
- Hiq akullin dhe dëborën e mbledhur nga ballkone, ulluqe etj
- Mos kalo poshtë strehëve, çative, pemëve: mund të shkëputen blloqe akulli ose dëbore
- Mos harro të veshësh këpucë që nuk rrëshqasin për të parandaluar rënie të rezikshme.

### Pas reshjeve të dëborës

- Pas rreshjeve të dëborës është e mundur formimi i akullit në rrugë dhe në trotuar, në qoftë se je me makinë vazhdo rrugën me kujdes
- Kujdes nga blloqet e dëborës apo akullit që bien nga çatitë, shtyllat, pemët etj. sepse mund të të godasin.

## TËRMET

### HYRJE

Territori i komunës sonë bën pjesë në Klasën Sizmike 4 (rrezik shumë i ulët) me përjashtim të disa zonave të vendosura në alta VALPOLCEVERA , alta VALBISAGNO DHE në LEVANTE të cilat klasifikohen në Klasën Sizmike 3 (rrezik i ulët). Ngjarjet sizmike - meqë nuk janë të lidhura me faktorë të motit - nuk janë të parashikueshme, për më tepër lëkundja e tokës ndodh papritur. Informacione shtesë në lidhje me rrezikun e tërmjetit mund të gjeni në sitin [www.ingv.it](http://www.ingv.it) Kështu që është e rëndësishme të mos gjendesh i papërgatitur por të planifikosh, për shembull, përmirësimë strukturore që mund të bëhen në ndërtesën në të cilën jetojmë, duke përforçuar



muret mbajtëse, nëse është e nevojshme, si dhe lidhjen midis mureve dhe soletës. Në këto raste, është mirë t'i drejtosh një tekniku i cili do të të ofrojë zgjidhjen më të përshtatshme. Në rast tërmjeti, është thelbësore që të përpinqesh të ruash qetësinë dhe të zbatosh rregullat e vetëmbrojtjes të parashikuara për këtë rrezik, duke vlerësuar që më parë zonat e shtëpisë apo ndonjë dhomë të veçantë më të sigurtë. Muret mbajtëse ose ato perimetrale, cepat e dhomave, hapësira e dyerive (nëse janë vendet më të sigurta në shtëpi, por edhe poshtë arkitrarëve, trarëve, tavolinave dhe krevateve.

Mund të bësh më të sigurta ambientet në të cilat jeton, duke marrë këto masa parandaluese:

- fikso mirë në mure të gjitha orenditë që mund të bien gjatë një tërmeti: plane, rafte, piktura...
- vendos sendet e rënda në pjesën e poshtme të mobilieve, në pjesët e larta mund të vendosësh sende të lehta të fiksuar me ngjitës

- largo mobiliet e rënda nga krevatet dhe divanet
- mëso ku ndodhen dhe si mbyllen rrubinetat e gazit, ujit dhe siguresa e dritave
- mbaj në shtëpi kuti të ndihmës së shpejtë, radio me bateri, elektik dore, fikës zjarri
- konsulto Planin Komunal të Urgjencës, të Komunës Genova në sitin [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it).

## RREGULLAT E SJELLES

### Gjatë tërmetit

Nëse nuk është e nevojshme mos përdor telefonin celular.

#### NËSE JE NË NJË VEND TË MBYLLUR:

- mos dil jashtë gjatë një tërmeti dhe mos përdor shkallët ose ashensorët, janë struktura të paqën-drueshme
- kërko strehim nën arkitrarë, trarë ose mure të jashtme të shtëpisë (larg nga dritaret)
- largohu nga të gjitha objektet, që duke rënë, mund të të godasin.

#### NËSE JE JASHTË:

- largohu prej ndërtesave, shtyllave të dritave, pemëve, linjave elektrike
- me makinë apo në këmbë mos kalo nëpër ura, pranë terreneve që mund të shemben ose në plazhe (mund të goditeshni nga valë të pazakonshme).

### Pas tërmetit

- Sigurohu mbi gjendjen shëndetësore të atyre që gjenden pranë teje dhe nëse është e nevojshme, jep ndihmën e parë, por mos lëviz nga vendi personat e plagosur rëndë
- Dil jashtë me kujdes duke u siguar se nuk ka shkëputje materialesh nga ndërtesa ku gjendesh dhe vish këpucë që të të mbrojnë nga xamat e thyer...
- Vendosu në një vend të sigurt, larg nga ndërtesat ose strukturat në rrezik
- Kufizo përdorimin e telefonit/celularit
- Nëse nuk është e nevojshme, mos e përdor makinën... mund të bëhes pengesë për automjetet e urgjencës.

Sa më shpejt të mundesh, informohu mbi të dhënat dhe rekomandimet e ofruara nga Autoritetet përmes faqes [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it) në faqen tonë Facebook - Twitter dhe ato të Komunës, televizionet dhe radiot lokale, tabelat rrugore dhe tabelat në stacionet të autobusëve.

# ZJARRET

## HYRJE

Pothuajse tē gjitha zjarret ndodhin me dashje ose nga pakujdesia, rrallē ndodhin pēr shkak tē faktorëve natyrorë, si vetendezja apo rrufetë. Mbrojtja Civile merret kryesisht me "zjarret kufitare", me fjalë tē tjera, zjarre qē ndodhin nē pyjet pranë qendrave urbane, shtepive, rrugëve, autostradave, vendeve tē frekuentuara nga njerëzit. Strukturat e banimit, apo ato qē pērdoren pēr qëllime tē tjera, nē përgjithësi, nuk e kanë zonën e sigurisë, qē parashikohet tē jetë pa bimë pérreth, dhe kjo i bën jashstëzakonisht tē pambrojtura nē raste zjarresh me intensitet tē lartë. Pēr ményrën e ndërtimit tē territorit tē saj, Genova



është e shkëputur têrësisht nga zonat e gjelbra tē prirura pēr këtë lloj rreziku.

Tē parandalohen zjarret është e mundur duke zbatuar disa rregulla tē thjeshta. Shkaqet mē tē shpeshta tē zjarreve, nē fakt, ndodhin nga:

- bishta cigaresh tē ndezura tē hedhura nē pyll ose nē buzë tē pyllit
- barbecue nē zonat jo posaçërisht tē krijuara
- barëra tē thata tē pa kontrolluara
- marmita e automjeteve tē parkuara nē bar apo shkurre tē thata
- hedhja nē pyll e mbeturinave tē cilat mund tē marrin zjarr lehtësisht.

## RREGULLAT E SJELLJES

### Gjatë një zjarri

#### KUR SHIKON NJË ZJARR TELEFONO MENJËHERË:

1515 Shërbimi Pyjor

115 Zjarrfikësit

800 807047 Sistemi Rajonal i Zjarreve Pyjore

#### NË QOFTË GJENDESH NË NJË VEND TË MBYLLUR DHE NUK MUND TË LARGOHESH NË SIGURI:

- mbyll dyert me ngjitës ose mbyll me lecka tē lagura hapësirat
- merr frymë përmes një lecke tē lagur
- shtrihu nē tokë, do kesh mē shumë oksigjen.

#### NË QOFTË SE GJENDESH JASHTË:

- kërko një drejtim shpëtimi, dil menjëherë nē rruge ose pranë një rrjedhje uji
- nē qoftë se nuk mund tē largohesh, hiq këmishën ose xhupin dhe merr frymë përmes tyre
- shtrihu nē tokë ku nuk ka gjelbërim: do tē kesh mē shumë oksigjen
- zjarri ka tendencën tē ngjitet lart, kështu qē nëse ju jeni nē një mal, zbrit nē luginë duke qëndruar kundër erës.

# RRËSHQITJE DHEU

## HYRJE

Informohu nëse komuna ka zona të rrezikshme rrëshqitjesh (shih në Hartografia në sitin [www.comune.genova.it](http://www.comune.genova.it)).

Shiko me kujdes tabelat që tregojnë rrezikun e rrëshqitjeve të dheut dhe të ndonjë kufizimi të kalimit ose bllokimi të rrugës.

Duke pasur parasysh kushtet e sigurisë, vëshgo terrenin pranë jush për të zbuluar prani rrëshqitjesh të vogla toke apo të çara në tokë, në shkëmbinj apo rrugë.

Kujdes edhe nga pemë të përkulura në qoftë se më parë nuk ishin ashtu. Në disa raste, ndryshime të vogla në hapesirë mund të konsiderohen si paraardhës të rrëshqitjeve e dheut. Ndonjëherë para rrëshqitjeve janë të dukshme në disa ndërtesa prishje dhe thyerje: disa mure kanë tendencë të kthehen ose të lëvizin. Ndonjëherë para rrëshqitjeve të dheut, janë të dukshme në disa ndërtesa lëndime ose thyerje: disa mure kanë tendencë të spostohen ose të lëvizin.

## RREGULLAT E SJELLJES

### Gjatë një rrëshqitje toke

#### NËSE GJENDESH JASHTË:

- nëse rrëshqitja vjen drejt teje ose ndodh poshtë teje, largohu sa më shpejt të jetë e mundur, kërko një vend të lartë e të qëndrueshëm
- nëse nuk mund të largohesh, përkulu dhe mblidhu sa më shumë rreth vetes dhe mbro kokën
- mos u ndalo pranë shtyllave: mund të shemben ose të thyhen. Mos u afro në cep të tokës rrëshqitëse sepse është e paqëndrueshme
- kujdes gurët ose objekte të tjera, që duke lëvizur mund të të godasin
- në qoftë se je duke rrugëtar dhe vë re një rrëshqitje që sapo ka ndodhur, mundohu të lajmërosh përrrezikun makinat e tjera dhe telefono numrin 115, Zjarrfikësit.

#### NËSE JE NË AMBJENT TË MBYLLUR DHE KUPTON SE PO NDODH NJË RRËSHQITJE:

- shtrihu poshtë një tavoline, poshtë arkitrarëve ose në afërsi të mureve mbajtëse, mund të të mbrojnë nga rreziqet e mundshme
- largohu nga dritaret, dyert prej xhami dhe mobiljeve që mund të bien dhe mund të të plagosin.

### Pas rrëshqitjeve

- Sinjalizo rrezikun Autoriteteteve si dhe për praninë e ndonjë të plagosuri. Lajmëro gjithashtu për ndonjë ndërprerje rruge ose të linjave të energjisë elektrike, gazit, ujit
- Telefono numrin 115 Zjarrfikëset.